

re dhite miratimi

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Kuvendi i Kosovës
Seanca Plenare e Kuvendit
Seanca nr. 2002/18
Prishtinë, më 31 tetor 2002, ora 10.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla plenare

PROCESVERBAL

Mbledhjen e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit.
Kryesuesi pasi konstatoi numrin e deputetëve prezentë në seancë gjithsej 91, propozoi këtë

REND TË DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar
- 3.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Telekomunikacionin (2002/7),
- 3.2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mbrojtjen e Ambientit (2002/8),
- 3.3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Aktivitetet e Tregtisë me Jashtë (2002/6) (të konfirmohet)
4. Parashtrimi i pyetjeve

1. Miratimi i rendit të ditës

Fatmir Limaj: Pas një fushate kulturore demokratike që kanë zhvilluar subjektet politike në Kosovë, pas rezultateve zgjedhore ku për asnjërën parti politike dhe në të paktën si grup parlamentar i Partisë Demokratike mendojmë se nuk ka qenë i diskutueshëm rezultati zgjedhor, ndodhi një ngjarje tragjike ku me një rast aksidental tragjik humbi jetën kryetari i komunës së Suharekës z. Ukë Bytuqi, përmes së cilës ne si grup parlamentar i PD-së e ngushllojmë familjen e tij dhe Asamblen komunale të Therandës. Fatkeqësisht ky rast tragjik u politizua dhe u keq përdor në masë jo të

drejtë që më së shumti dëmtoi qytetarin e Kosovës. Rastet e tilla tragjike ndodhin çdo kund, rasti kriminal duhet të dënohet personi që ka veprimë të till dihet me emër e mbiemër, organet gjyqësore – policore janë ato të cilat duhet të mirrën me atë rast. Është mirë që ne si deputet, si institucione t'i respektojmë organet tona ligjore dhe njëkohësisht nga ku vend t'i çojmë mesazhet tona dhe qetësimin e qytetarëve, jo ta politizojmë rastin e tillë.

Dragisha Krstoviq: Kam vërejtje në propozimin e rendit të ditës dhe propozoj që shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Tregtin e Jashtme të hiqet nga rendi i ditës me arsyetim se nuk e ka shqyrtuar Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Bashkësive që është paraparë me nenin 9.1. të Kornizës Kushtetuese dhe Rregullës 29 të Rregullores së Punës të Kuvendit. Prandaj, mendoj se nuk janë plotësuar kushtet e cekura më lartë.

Kolë Berisha: Ukë Bytyqi dikur ishte anëtar i këtij Parlamenti, atëherë kur duhet t'i thuhej "Jo" Serbisë. Prandaj, mendoj se punimet e kësaj seance duhet të fillojmë me një minutë heshtje, për nderimin e tij.

Kryesuesi: Unë do ta doja përkrahjen unike të përbërjes së plotë të Parlamentit lidhur me këtë çështje. Ukë Bytyqi ka participuar një kohë të gjatë në luftë për lirinë e Kosovës, pjesëmarës aktiv si deputet i shumëhershëm i Parlamentit të Kosovës dhe ju ftoj një minutë heshtja t'ia bëjmë nderimet e fundit.

Iu bë nderimet e fundit me një minutë heshtje, nga deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Kryesuesi: Kryesia e Kuvendit, pas një konsultimi është e mendimit që shqyrtimi i dytë i P/ligjit për Tregtin e Jashtme të hiqet nga rendi i ditës për arsye se komisionet e Kuvendit nuk e kanë shqyrtuar atë.

Gani Prekopuca: Unë dua ta përsërisht këtë Parlament dhe juve zotërinjë të Kryesisë – cili është në radhë prej neve, cili do të shkojë dhe më vonë të themi se ka ndodhur një aksident? Deri kur Parlamenti do të heshtë dhe nuk do të kërkojë nga shërbimi i cili është përgjegjës për sigurinë e qytetarëve të Kosovës.

Kryesuesi: Ne jemi marrë vesh bashkarisht njëzëri që një ditë në rend të ditës si temë kryesore seancës Plenare të jetë çështja e sigurisë në Kosovë. Parlamenti duhet të jetë institucion i cili do të ndikojë vërtetë në zbardhjen e çdo të keqeje, por edhe në uljen e tensioneve, në krijimin e një klime konstruktive për punë në mënyrë që Kosovës do të bëjmë ligje me të cilat do të menjanohet të gjitha të këqijat.

Rangjel Nojkiq: Në bazë të Rregullës 17.2 Rregullores së Punës së Kuvendit propozoj që të tërhiqet nga procedura P/ligji për Telekomunikacionin për arsye se kanë arritur disa vërejtje nga Zyra ligjore e PSSP.

Bajrush Xhemajli: Sa i përket rendit të ditës u tha se komisionet nuk e kanë kryer punën e tyre. Ne, Komision për Tregtin dhe Industri e kemi kryer punën tonë menjëherë pas shqyrtimit të ligjit.

Kryesuesi: Unë propozoj që rendi i ditës të vëhet në votim, duke hequr shqyrtimin e dytë të P/ligjit për Tregtinë e Jashtme. Propozimi u dha në votim. Rezulltati ishte:

Për	83
Kundër	14
Abstenime	1

2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar

Nuk pati vërejtje në procesverbal dhe ai u miratua nga të pranishmit.

3.1. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për Telekomunikacionin

Kryesuesi ftoi sponzorusin e P/ligjit që të arsyetojë atë.

Ministri Zef Morina, paraqiti ekspozitën lidhur me P/ligjin për telekomunikacion. Ndër të tjera, ai theksoi se ky P/ligj është identifikuar si akt me prioritet të lartë i jep zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Me miratimin e tij, në tregun kosovar hap një konkurrencë të shëndoshë, e cila mundëson investime të brendshme dhe të jashtme. P/ligji ritë transparencën dhe efikasitetin e telekomunikacionit nëpërmjet rregullatorit të pavarur. Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, afron tretman të barabartë për ofruesit e shërbimeve në kushte jodiskriminuese për të gjithë shfrytëzuesit. Në vazhdim, ministri Morina elaboroi veçmas dispozitat e kapitujve të P/ligjit, të cilët janë dhënë në shtojcën e Transkriptit.

Edita Tahiri: Në bazë të shqyrtimit që i kanë bërë këtij P/ligjit, mund të them se në parim kjo është një Kornizë adekuate ligjore e cila krijon mundësinë e një zhvillimi të një telekomunikacioni modern në Kosovë si dhe është kompatibil me kriteret ndërkombëtare. Ky P/ligj ndjek konceptin e liberalizimit të tregut të telekomunikacionit që është në përputhje me sunimet e Kosovës për reforma ekonomike dhe demokratike që i përgjigjen kriterëve të OBT dhe BE-së. Ajo pati edhe disa propozime konkrete në P/ligj të cilat janë bashkangjitur në Transkript.

Gojko Saviç: Ministri i cili referoi për P/ligjin në fjalë ishte i qartë për shumicën. Por, ne deputetët serbë askush asgjë nuk ka kuptuar nga se perkthimi nuk ishte në nivel, dëgjoheshin nga dytre zëra dhe zhurmë. Kjo ka ndodhur edhe gjatë votimit kur nuk kemi kuptuar se për çka po votohet, Mendoj se është e pamundur që të kuptohet ajo se çka ka ndodhur.

Ramadan Kelmendi: Shqyrtimi dhe miratimi i P/ligjit për Telekomunikacion në Kosovë është një hap i rëndësishëm dhe i nevojshëm për zhvillimin e Kosovës. Ai

propozoi disa sygjerrime konkrete që të inkorporohen në tekstin e P/ligjit, të cilat i bashkangjiten Transkriptit.

Bujar Dugolli: Ky projektligj është me rëndësi të veçantë, sepse bazohet në ligjet ndërkombëtare dhe kanë punuar ekspertët ndërkombëtarë e vendorë në hartimin e tij dhe ne i përgëzojmë dhe i përshëndesim si ministrin, ashtu edhe ekspertët të cilët kanë hartuar këtë P/ligj. Por unë kam një brengë, e besoj edhe shumë deputetë të tjerë, në të ashtuquajturat pjesë të rezervuara që pengojnë zhvillimin e Kosovës, po e pengojnë edhe miratimin e ligjeve. Ne, si grup parlamentar, e mbështesim në parim këtë P/ligj.

Hydajet Hyseni: Kosovës i duhet një ligj i mirëfillt për telekomunikacion dhe ne e mbështesim. Në P/ligjin e propozuar unë kam një sërë vërejtjesh. Së pari, si zakonisht P/ligji ka një shpërputhje të madhe midis verzioneve të gjuhëve të ndryshme, por kjo nuk është vetëm çështje gjuhësore por kthehet shpesh edhe në çështje përmbajtësore. Ai pati disa vërejtje, dhe sygjerrime konkrete, të cilat i janë bashkangjitur Transkriptit.

Kryesuesi: Mendoj që komisionet kryesore dhe ato funksionale të Kuvendit do t'i kenë parasysh të gjitha vërejtjet dhe sygjerrimet e deputetëve, gjatë shqyrtimit të këtij P/ligjit. Kryesuesi dha në votim këtë P/ligj, rezultati ishte:

Për 76,
Kundër..... 4,
Abstenime..... 6.

3.2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për Mbrojtjen e Ambientit.

Kryesuesi: Një sygjerrim, para se të kalojmë në shqyrtimin e parë të P/ligjit. Vërejtjet që janë bërë nga Zyra ligjore e PSSP, atë që u tha në fillim të hyrjes, unë kam sygjerruar që t'iu shpërndahen komisioneve përkatëse. Prandaj, lus të gjitha grupet parlamentare që kanë ndonjë propozim konkret për përmirësimin e cilësisë së P/ligjit që në formë të amendamenteve me kohë t'i paraqesin propozimet e veta që komisionet të mundën në mënyrë profesionale t'i shqyrtojnë ato.

Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor z. Ethem Çeku në ekspozenë e tij lidhur me P/ligjin për Mbrojtjen e Ambientit theksoi shkallën e lartë të ndotjes industriale e veçmas në komunën e Mitrovicës dhe të Prishtinës ku niveli i ndotjes kalon dhjetëra herë standardet e lejuara si pasojë e mungesës së infrastrukturës ligjore në lëmin e mbrojtjes së ambientit dhe zbatueshmërisë e dobët të akteve ekzistuese ligjore. Në vazhdim, ai theksoi se ky P/ligj përcakton parimet themelore të mbrojtjes së ambientit, përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës si dhe palëve juridike dhe fizike për sigurimin e kushteve për një ambientë të pastër dhe zhvillim të qëndrueshëm. Pastaj, ai vazhdoi me elaborimin e dispozitave të kapitujve kryesor të P/ligjit për Mbrojtjen e Ambientit, të cilat janë dhënë në shtojcë të Transkriptit.

Sanije Alaj: Shprehi kënaqësinë time që sot në këtë seancë plenare bëhet shqyrtimi i parë i dy P/ligjeve që janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e Kosovës. Ky P/ligj ofron të gjitha mundësitë për një ambient të shëndoshë dhe zhvillim të qëndrueshëm, ofron mundësitë për krijimin e rregullave për parandalimin e përhapjeve të materieve të dëmshme dhe të rezikshme në ajër, ujë dhe në tokë. Konsideroj se Qeveria e Kosovës duhet të nxjerrë akte për caktimin dhe mbrojtjen e parqeve nacionale si Malet e Sharit për park nacional, për caktimin dhe mbrojtjen e burimeve termike të rajoneve, rekreative dhe banjave të Kosovës.

Haki Shatri: Duke respektuar angazhimin e organeve tona ekzekutive, si dhe duke respektuar fjalën hyrëse të z. ministër, më lejoni që t'i shpreh shqetësimet e mia lidhur me disa zgjidhje të cilat në këtë P/ligj janë propozuar e të cilat nëse miratohen si të tilla, gjatë zbatimit të tyre do të prodhojnë efekte negative dhe pengesa për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Nuk është respektuar parimi i baraspeshës në mes çëllimit për zhvillimin dinamik ekonomik dhe kërkesës për mbrojtjen e ambientit. Nuk ka vlerësim për ndikimin në buxhet, sidomos të agjensioni i propozuar që të menaxhoj me dy institucionet përkatëse. Propozimi për formimin eko-fondit dhe vënia e taksave është në kundërshtim me disa nga ligjet tona tash më të miratuara. Propozoj që propozuesi i këtij P/ligji ta tërheqë atë nga procedura e miratimit.

Smilka Milosavljeviç: Sa i përket këtij P/ligjit ai është në harmoni me standardet Evropiane dhe i përcakton parimet themelore për mbrojtjen e ambientit në kuptimin e përkufizimit të mbrojtjes së ambientit nga materiet e rezikshme si dhe locimit të tyre. Sa i përket kualicionit "Kthimi" ai nuk ka ndonjë vërejtje të theksuara por vetëm disa të cilat do t'i paraqesim në komisionin funksional të Kuvendit. Në parim ne e përkrahim këtë P/ligj.

Drita Statovci: P/ligjin duhet ta pranojmë dhe ta mbështesim por ky P/ligj duhet të jetë sa më i mirë dhe sa më i plotë. Kam disa sygjerime dhe plotësime. Ministria para se të lëshoj lejen ambientale ose licencën e parë duhet të ketë mendimin dhe pajtimin e institucioneve universitare, shkencore profesionale dhe të ekspertëve të fushave përkatëse: të arkeologëve, etnologve, antropologve. Ajo pati edhe disa propozime të cilat i janë bashkangjitur Transkriptit.

Naim Maloku: E përgëzoj Ministrinë që ka bërë hartimin e këtij P/ligji. Ky P/ligj do të pengojë që Kosova të bëhet poligon i arritjes së teknologjisë së vjetruar dhe të dyshimtë sa i përket mbrojtjes së ambientit nga investitorët e huajë. Gjenerata jonë është duke paguar një çmim të çështjes shumë të gabuar ndaj ambientit ku jemi duke jetuar. Duhet të kemi një ligj i cili do të bëjë kthesë në çasjen tonë ndaj ambientit dhe natyrës. Gjendja ekzistuese në kompleksin e KEK-ut, minierat sipërfaqësore Bardhi i Madh, Mirash fshatin Dardhishtë termocentralet e Kosovës A, janë në gjendje shkatruese ndaj natyrës dhe ambientit. Pra në emër të grupit parlamentar të AAK-së e mbështesim këtë P/ligj që të shkoj në procedurë të rregullt.

Esat Dauti: Propozimi për miratimin e P/ligjit për mbrojtjen e mjedisit është për tu falenderuar, është dashur të hartohet shumë më herët duke parë parasysh gjendjen ekologjike në territorin e Kosovës. E përkrahi në parim që ky ligj të bëhet sa më shpejtë. Ai pati disa vërejtje dhe sygjerime të cilat janë bashkangjitur Transkriptit.

Bogoljub Milosheviç: P/ligji është i mirë, por vetëm frigohem që ai nuk do të realizohet, duke pasur parasysh mentalitetin dhe shprehitë tona. Duhet të punojmë në edukimin dhe arsimimin e njerëzve për sjellje ekologjike.

Lulëzim Zeneli: Mendoj se me nxjerrjen e këtij P/ligji përmbillet ky kapitull. Veçantia e tij është se ky ligj është harmonizuar me të gjitha normat dhe parimet ndërkombëtare dhe të konventave për mbrojtjen e ambientit. Ajo çka është esenciale për Kosovën tash për tash këtij P/ligji i mungon një qasje konkrete e cila do të siguronte mbrojtjen gjegjësisht do të ndalonte ndotjen e ujërave.

Tomë Hajdaraj: Nga ekspozenë e ministrit thuhet se Kosova është vendi më i ndotur në Evropë me shkallën e ndotjes, dm. 15 fish mbi të lejuarën. Unë mendoj se kjo duhet të zbutet. Sa i përket ligjit mendoj se është dashur më shumë të bashkëpunohet me Ministrinë e Bujqësisë në hartimin e tij. Ai pati edhe disa vërejtje dhe sygjerime konkrete, të cilat i janë bashkangjitur Transkriptit.

Berat Luzha: Unë i bashkangjitem shqetësimeve dhe brengosjes së parafolësve të mijë për ndotjen dhe shkatërrimin e ambientit në Kosovë nxjerrja e një ligji të tillë për ambient është më se e domosdoshme. Mendoj se me këtë projektligj është paraparë formimi i një strukture të tepruar për kryerjen e punëve administrative, profesionale shkencore e tj në fushën e mbrojtjes së ambientit. Ai pati disa vërejtje dhe sygjerime të cilat janë bashkangjitur në Transkript.

Ibush Jonuzi: Ky projektligj është i një randësie të veçantë për të cilin ne kemi nevojë në afat sa më të shkurtër të hyjë në fuqi, por mendoj se si duhet të jetë i zbatueshëm në praktikë. Andaj e mbështesë atë që u tha më herët dhe e mbështesë në veçanti diskutimin e kolegut Shatri.

Sylejman Qerkezi: Mendoj në dy gjigantët që janë në komunën e Kastriotit. Këtu nuk përjashtohet at komuna e Mitrovicës, është koha për ministrin që në veçanti këto komuna të zënë vend të veçantë sa i përket çështjes së ambientit.

Exhlale Salihu: Unë do të ndërlihem me diskutimin dhe plotësimin e koleges sime Z.Statovci me vërejtjet e saj pajtohem plotësisht. Unë kisha shtuar: edhe mbrojtjen e lokaliteteve arkeologjike.

Hasan Meta: Në parim unë e mbështes këtë P/ligj dhe lus të gjithë ata që merren me veprimtari të ndryshme me mundësitë e veta të begatojnë atë dhe të jetë më rigoroz dhe decidiv në mënyrë që Kosova të ketë një ligj të kësaj natyre.

Gojko Saviç: Sot kemi në rend dite P/ligjin për të cilin të gjitha e ndajmë mendimin se jemi të rrezikuar në të njejtën mënyrë. Diskutimet ishin më konstruktive në këtë P/ligj se sa më P/ligjin për të drejtat e njeriut.

Fadil Kryeziu: Mendoj se kompetencat janë shumë të koncentruara në Ministri siç është çështja e lejeve të ndryshme, akreditimeve, liçensimeve, vlerësimeve etj. Pys, ku janë komunat ose organet lokale, në këtë rast mund të them se do të ketë keqëpërdorime nga më të ndryshmet.

Ramadan Kelmendi: Unë parimisht kam sygjerimet e përgjithshme dhe sygjerime konkrete në tekstin e P/ligjit. Vlersoj dhe çmoj grupin punues që ka bërë shumë punë të mirë si edhe Ministrinë e cila e ka hartuar këtë P/ligj. Vërejtjet e tij i janë bashkangjitur Transkriptit.

Kryesuesi: Ju falenderoj. Unë do të përfundojë me një sugjerim- lutje të gjithë deputetëve dhe komisioneve përkatëse që të mos prishet ekuilibri në mes të tre parametrave kryesorë që caktojnë jetën: a) zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; b) të drejtat e njeriut dhe c) e drejta për ambient të pastërt. Në emër të kësaj ju lus që të votojmë. Rezultati:

Për..... 88

Kundër..... 2

Abstenuan. 2

Pra konsiderojmë se P/ligji në parim u miratua dhe shkon në procedurë të mëtejme.

4. Të ndryshme

Asnjë pyetje nuk ishte paraqitur për këtë seancë konform Rregullores së Punës së Kuvendit.

Seanca plenare përfundoi në orën 13.35

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik Nexhat Daci